



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT URBAN DHE SHËRBIMEVE  
INFRASTRUKTURE  
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

**RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI:** - " Ndertim i ures se re mbi Perroin e Llixhes ne fshatin Jakodine ,Njesia administrative Shirgjan dhe Ndertim i ures se re mbi Perroin "Balta e Gaxhjes", ne rrugen e lagjes "Katund i Vjeter", Fshati Shushice,Njesia Adminstrative Shushice".

**Vendndodhja :** Fshati Jakodine ,Njesia administrative Shirgjan dhe Fshati Shushice, Njesia Adminstrative Shushice, Elbasan

**Qellimi:** Ndertim ure e re dhe Rikostruksjon i ures ekzistuese te poshteshenuara :

- " Ndertim i ures se re mbi Perroin e Llixhes ne fshatin Jakodine ,Njesia administrative Shirgjan , e cila do te sherbeje per lidhjen e fshatit Jakodine me fshatin Gjonme si pjese e rruges bujqesore qe lidh dy fshatrat pasi aktualisht levizja e mjeteve dhe kembesoreve behet nepermjet perroit te Perroit te Llixhes ne prani te ujrave te ketij Perroi duke sjelle edhe rrezikim te mjeteve bujqesore dhe kembesoreve qe kalojne ne te.
- " Rikostruksion i ures te perroit " Balta e Gaxhjes " ne rrugen e lagjes " Katund vjeter " , Fshati Shushice,Njesia Adminstrative Shushice, Elbasan

**PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES**

**1. Ndertim i ures se re mbi Perroin e Llixhes ne fshatin Jakodine**

Ne fshatin Jakodine Njesia Administrative Shirgjan ndodhet rruga bujqesore Jakodine – Gjonme e cila inceptohet me perroin e Llixhes ne distance rreth 500m nga rruga bujqesore Shirgjan – Gjergjan. Aktualisht levizja e mjeteve dhe kembesoreve behet nepermjet perroit te Perroit te Llixhes ne prani te ujrave te ketij Perroi duke sjelle edhe rrezikim te mjeteve bujqesore dhe kembesoreve qe kalojne ne te.

Gjendja faktike e ures paraqiten si në fotot e mëposhtme:

Fig.1 Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese

## 2. Ura e Përroit të Gurrës, në fshatin Katund i Vjetër, Njësia Administrative Shushicë.

Ura e Përroit të Gurrës, në fshatin Katund i Vjetër, Njësia Administrative Shushicë ndodhur në aksin rrugor “Katund i Vjetër” ka këto parametra: Hapësirë drite  $H_d = 3$  m dhe Gjërësi kaluese  $B = 4$  m, gjatësia e urës 5 m. Ura është e mbështetur mbi (shpatulla betoni mbi të cilat është betonuar soleta Beton arme). Aktualisht gjendja e ures paraqitet si vijon : Ujrat e perroit te Gurrës shkaktuar gerryerje e bazamentit te urës duke shembur dy ballnat e urës (shpatullat nga të dyja krahët ) duke e nxjerrë jashtë funksionimit këtë urë. Dëmtimi i ballnave ka ardhur si pasojë e gërryerjes së bazamentit edhe 60 cm nën kuotën e tabanit të mbështetjes, nga prurjet e përroit të Gurrës duke sjellë shembjen e kësaj ure. Gjendja faktike e ures paraqiten si në fotot e mëposhtme:



Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese

### **QËLLIMI I PROJEKTIT**

Ky projekt kryhet për objektet : " Ndertim i ures se re mbi Perroit e Llixhes ne fshatin Jakodine ,Njesia administrative Shirgjan dhe objekti : " Rikostruksion i ures te perroit " Balta e Gaxhjes " ne rrugen e lagjes " Katund vjeter ".Realimi i projektit per keto objekte do te mundesoje lidhjen e fshatit Jakodine me fshatin Gjonme si pjese e rruges bujqesore qe lidh dy fshatrat dhe kalimin e mjeteve ne aksin rrugor "Katund i Vjetër" ne fshatin Shushice.

## PUNIMET QE DO TE KRYHEN DHE VOLUMET E PUNIMEVE

1. Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : " Ndertim i ures se re mbi Perroin e Llixhes ne fshatin Jakodine , Njesia administrative Shirgjan, jane :

- Ndertim i tombinos b/a boks (3\*3 ) m me gjeresi B = 5m
- Ndertim i kater speronave betonit me ggatesi L = 5m dhe lartesi te ndryshueshme nga H = 1- 4.2m .
- Mbushje me cakull mbi tombinon e re .

2. Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : " Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Perroin "Balta e Gaxhjes", ne rrugen e lagjes "Katund i Vjeter", Fshati Shushice,Njesia Adminstrative Shushice" " , jane :

- Prishje te shtrsa betoni dhe mureve te gurit ekzistues te ures
- F.V Tombino fi1200 mm b/a
- Beton C 16/20 per H/D
- Mbushje me cakull mbi tombinon e re .

Volumet e punimeve janë nxjerrë nga planimetria dhe sipas seksioneve tërthore.

Janë bërë llogaritjet e kuotave, të tabanit dhe kuota e projektit me qëllim funksionimin sipas parametrave të projektuar për seksionet.

## PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve, specifikimet për objektin " Ndertim i ures se re mbi Perroin e Llixhes ne fshatin Jakodine dhe objekti " Rikostruksion i ures se Gurrës, në fshatin Katund i Vjetër, Njësia Administrative Shushicë", jane bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.

Punoi: Ing.Arian Baku



MIRATOI  
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE  
Ndricim Sinani

